



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

MIRATOHET
DREJTOR
EUGENA TOMINI

POLITIKAT E PRIVATËSISË
INSTITUTI SHËNDETIT PUBLIK

Politikat e privatësisë

Kjo politikë informon se si Instituti i Shëndetit Publik mbledh dhe përdor të dhënat personale të individëve, vizitorëve, kandidatëve që marrin pjesë në procesin e rekrutimit të nëpunësve/punonjësve të ardhshëm të Institutit të Shëndetit Publik, individëve që ankohen në lidhje me problematikat apo mbarëvajtjen e shërbimeve që ofrojmë etj, dhe ku përpunimi i të cilave kryhet pas dhënies së pëlqimit nga subjekti i të dhënave personale dhe/ose në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Instituti i Shëndetit Publik organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit Nr.10 138, datë 11.5.2009, “Për Shëndetin Publik” dhe ligjit 15/2016 “ Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, Rregullores së Brendshme për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e ISHP-së, si dhe çdo akti ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Instituti i Shëndetit Publik disponon faqen www.ishp.gov.al, është institucion kërkimor shkencor që përgjigjet për sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit të komunitetit, duke siguruar informacion të besueshëm, duke nxitur e sugjeruar politikat dhe strategjitë në fushën e shëndetit publik, si dhe duke promovuar shëndetin në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj faqe web, çdo individ mund të aksesojë informacionin/shërbimin në mënyrë të plotë, të saktë, në formën më të përshtatshme duke siguruar në këtë mënyrë shërbime më të mira publike.

Objekti i Politikave të privatësisë

Ky dokument ka për objekt informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që janë marrë për të dhënat që deklarohen në faqen web, procese të cilat realizohen në përputhje të plotë me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për mbrojtjen e të dhënave personale në Republikën e Shqipërisë.

Përdorimi i të dhënave personale

Të dhënat personale mund të përdoren për të komunikuar me vizitorët, ankuesit apo çdo subjekt të interesuar, për qëllime historike, shkencore ose statistikore, për ndjekjen dhe përfundimin e procedurave të punësimit, të rregulluara nga legjislacioni përkatës etj, duke siguruar se ato nuk përpunohen për të marrë masa apo vendime për një individ, si dhe duke garantuar konfidencialitetin e informacionit të siguruar.

Instituti i Shëndetit Publik kryen përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Siguria

Instituti i Shëndetit Publik siguron çdo përdorues që të dhënat që mbërrijnë në bazën e të dhënave të saj, i sigurohen me sistemin më të lartë të sigurisë dhe njëkohësisht është e përkushtuar të zbatojë rigorozisht të gjithë kuadrin ligjor në mbrojtje dhe respektim të çdo veprimi që lidhet me të dhënat e përdoruesve, sipas parashikimeve të [ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave](#)

[personale”, të ndryshuar](#) dhe çdo akti tjetër të miratuar nga Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Mbrojtja e të dhënave personale

Mbrojtja e të dhënave personale bazohet në:

- Përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- Grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime;
- Mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- Mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar;
- Saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe kur është e nevojshme, duhet të përditësohen, duke ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për të fshirë apo korrigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur.

Instituti i Shëndetit Publik merr përsipër të mbrojë dhe të moskeqpërdorë për asnjë rast këto të dhëna.

E drejta për t'u ankuar

Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë, në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi.

Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale,

Adresa: Rruga “A. Toptani”, Kati II-të.

www.idp.al

Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

Pyetje/Ankesa/Informacion

Me anë të informacionit të mësipërm shpresojmë t’ju kemi informuar në mënyrë të plotë rreth çështjeve të privatësisë, në funksion të përdorimit të faqes web të Institutit të Shëndetit Publik.

Për çdo kërkesë, informacion apo problematikë të mundshme në lidhje me faqen:

web: www.ishp.gov.al, lutemi të na kontaktoni në:

e-mail: ishp@shendetsia.gov.al

Ofruesi: Instituti i Shëndetit Publik

Rr. "Aleksandër Moisiu"

Tiranë,